


EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7922
E hënë, 4 nëntor 2024
Çmimi 0.50

Me Harrisin pak pritje
për Kosovën, me Trumpin
turbullira | PAGE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (PDK) KA SHPALOSUR SLOGANIN
DHE PROGRAMIN QEVERISËS: "KOSOVA MUNDËT MA MIRË"

ME BEDRI HAMZËN KRYEMINISTËR 'KOSOVA MUNDËT MA MIRË'

| PAGE 4-5

"Pagat në sektorin publik do të rriten 50 % për shërbyesit civilë, mjekët, infermierët, mësuesit, profesorët, zjarrfikësit, ushtarët, policët e të gjithë ata që marrin rroga nga buxheti i shtetit", ka thënë Bedri Hamza



Kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, ka shpalosur sloganin e fushatës për zgjedhjet e 9 shkurtit "Kosova mundet ma mirë". Ai ka

paraqitur platformën e tij përmes së cilës, ndër të tjera, do t'i përmbushë pesë qëllime: zhvillimin ekonomik të vendit, rritjen e pagave dhe pensione,

përgatitjen e të rinjve për tregun e punës përmes investimeve në arsim, përmirësimin e sistemit shëndetësor, raportet e mira me aleatët

SHQIPTARËT
E LUGINËS
PROTESTOJNË
KUNDËR
PASIVIZIMIT
TË ADRESAVE F. 8



KATËR VJET
NGA ARRESTIMI
I JSH-KRERËVE
TË UÇK-së, A PO
I VJEN FUNDI
GJYKIMIT TË
MADH NË HAGË? F. 7



RRITJA E TURIZMIT NË SHQIPËRI:
ÇFARË TREGOJNË TË DHËNAT? F. 7

RAPORTI I KE-së PËR KOSOVËN:
PROBLEME ME TREGUN E PUNËS DHE
EMIGRIM I LARTË F. 7

SPORT



FITOJNË YLLI DHE PRISHTINA, TREPÇA
NJOFTON BASHKIMIN ME HUMBJE F. 10

RENOVA
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Me Harrisin pak pritje për Kosovën, me Trumpin turbullira

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Zgjedhjet e amerikanëve më 5 nëntor do të ndihen anembanë globit - deri në Kosovë. Në garë për të parin e Shtëpisë së Bardhë janë Kamala Harris nga Partia Demokratike, aktualisht zëvendës-presidente, dhe Donald Trump nga Partia Republikane dhe president nga viti 2017 deri më 2021.

Kosova përgjatë viteve ka qenë vazhdimisht në vëmendjen e ShBA-së pavarësisht prej leadershipit të saj politik.

Nën presidentin demokrat Bill Clinton, më 1999, ShBA-ja dhe aleatë të tjerë të NATO-s kanë bombarduar caqet e ushtrisë së atëhershme jugosllave për ta ndaluar dhunën në Kosovë. Gati dhjetë vjet më vonë, nën presidentin republikan George W. Bush, Kosova ka shpallur pavarësinë.

Edhe administrata e tanishme, ku bën pjesë Harris, ka inkurajuar vazhdimisht Kosovën t'i normalizojë marrëdhëniet me Serbinë, si kusht për të ecur përpara në rrugën e integritit evropian, ndërsa Trumpi si president ka qenë dëshmitar i nënshkrimit të një marrëveshjeje në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike.

Për kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, rezultati i zgjedhjeve të 5 nëntorit duket se do të ketë pak pasojë për bashkëpunimin dhe partneritetin e vazhdueshëm. Ai mbetet i bindur se përkushtimi i tij për t'u angazhuar me liderë me prejardhje të ndryshme politike do të vazhdojë. "Unë jam kryeministër i Republikës së Kosovës dhe bashkëpunoj me udhëheqës të shteteve që janë nga të gjitha anët e spektrit politik - kjo si kryeministër. Si kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, natyrisht që jam socialdemokrat, jam demokrat dhe nuk kam asgjë të re të shtoj", tha Kurti në një konferencë për gazetarët në Prishtinë.

Për analistët në ShBA, situata nuk do të jetë aq e thjeshtë. Fillimisht, me luftën në Ukrainë, konfliktin në Lindjen e Mesme dhe kontestin territorial në Detin e Kinës Jugore, Kosova nuk do të depërtojë lart në agjendë, sipas tyre.

Pastaj, në garë janë edhe dy kandidatë krejtësisht të ndryshëm - Harris me fare përvojë në Ballkanin Perëndimor dhe Trump i njohur për qasje transaksionale, apo 'shit e blej'. Frank Wisner, ish-emisar i ShBA-së për statusin e Kosovës, thotë për programin Expose të Radios Evropa e Lirë se problemi më i madh i Kosovës është mosmarrëveshja me Serbinë, e cila vazhdon të mos ia njohë pavarësinë, edhe gati 17 vjet pas shpalljes.



Wisner nuk pret ndonjë lëvizje në këtë drejtim nëse Harris zgjidhet presidente. "Unë supozoj se administrata e Harrisit do të ndiqte synime më pak ambicioze. Ajo do të bënte përpjekje t'i ulte Kosovën e Serbinë në një tryezë, bashkë me evropianët, por do të synonte përparime më të vogla - në ekonomi, tregti, kulturë, lëvizje njerëzish... Pra, në gjëra që fillojnë ta ulin temperaturën mes dy vendeve", thotë Wisner.

David Phillips, drejtor i Programit për Ndërtimin e Paqes dhe të Drejtat e Njeriut në Universitetin e Kolumbias, shpreh pikëpamje të ngjashme për Harrisin. Ai nuk pret ndonjë veprim domethënës prej saj në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Ajo është mbështetëse e sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut. Andaj ka të ngjarë ta vëmë re këtë jo vetëm në Kosovë, por kudo në botë. Mund të presim që ajo të bëhet kampione e shtetit ligjor dhe e luftës kundër kleptokracisë", thotë Phillips.

Për Trumpin, pritshmëritë janë dukshëm më shqetësuese. Të dy ekspertët druajnë se qasja e tij "transaksionale" mund të çojë në pasojë të paparashikueshme dhe potencialisht të rrezikshme për të ardhmen e Kosovës.

Wisneri nuk e përjashton mundësinë që Trumpi ta eksplorojë ndarjen e Kosovës si zgjidhje të shpejtë për konfliktin e saj të vazhdueshëm me Serbinë. "Nëse ai sheh ndonjë marrëveshje me [presidentin e Serbisë, Aleksandar] Vuçiq, që i përshtatet, ai nuk do ta presë Kosovën që të bindet. Ai do të jetë transaksional, në kërkim të një marrëveshjeje, në kërkim të një përparimi, në kërkim të diçkaje që e bën të duket mirë. Kosova duhet të jetë e shkathët, të sigurohet se ka mbështetje të

fortë nga evropianët, por rrugëtimi i saj mund të jetë i vështirë", thotë Wisner.

Wisner kujton se një marrëveshje për shkëmbim terriroresh në mes të Kosovës dhe Serbisë, përgjatë vijave etnike, është përfolur në vitin 2020, gjatë mandatit të parë presidencial të Trumpit. Por, plani nuk ka shkuar përpara pasi presidenti i atëhershëm i Kosovës, Hashim Thaçi, i është dorëzuar Gjykatës Speciale në Hagë si i dyshuar për krime lufte. Phillips thotë, po ashtu, se Trumpi e sheh ndarjen e Kosovës si zgjidhje të shpejtë për marrëdhëniet e saj të trazuar etnike dhe kjo, sipas tij, jo vetëm se do ta destabilizonte Kosovën, por do ta hapte Kutinë e Pandorës edhe në shtete të tjera multietnike të Ballkanit, si Maqedonia e Veriut, Bosnjë-Hercegovina apo Serbia. "Nëse Trump zgjidhet, ka gjasa të shohim një ndryshim të madh në qasjen e shteteve të Bashkuara. Trumpi ka interesa financiare në Ballkan. Ai ka interesa të dëshmuara në transaksione në favor të ShBA-së", thotë Phillips për "Exposenë".

Në shtator të këtij viti, djali i madh i Trumpit, Donald Jr., ka darkuar me biznesmenë serbë në Beograd, për t'i diskutuar mundësitë për investime.

Paraprakisht, në maj, dhëndri i Trumpit, Jared Kushner, ka bërë kontratë me shtetin e Serbisë për ndërtimin e një hoteli luksoz në vendin e një ish-baze ushtarake në Beograd.

Richard Grenell, i cili në kohën e administratës Trump ka qenë përfaqësues i ShBA-së në dialogun Kosovë - Serbi dhe ka shtyrë përpara marrëveshjen për shkëmbim terriroresh, ka zhvilluar, po ashtu, marrëdhënie të ngushta me Qeverinë e Serbisë. Në vitin 2023 Vuçiqi i ka dhënë atij Urdhrin e Flamurit

Serb, duke thënë se Grenelli "ka qenë ndër të paktët njerëz në ShBA që ka pasur qasje të ekuilibruar ndaj Kosovës".

Donald Trump Jr. e ka cilësuar Grenellin si "pretendent kryesor për pozitën e sekretarit të Shtetit", nëse babai i tij do ta merrte timonin e Shtëpisë së Bardhë. Për Wisnerin, ky nuk do të ishte një lajm i mirë. "Nuk dua të tingëlloj tepër i ashpër, por mendoj se ai i ka bërë dëm të madh politikës së jashtme amerikane në rajon, duke dalë me ide që nuk kanë qenë të arritshme", thotë ai.

Gjatë presidencës, Trumpi dhe administrata e tij kanë paralajmëruar në disa raste edhe për mundësinë e tërheqjes së trupave amerikane nga Kosova. Prania e tyre në kuadër të misionit paqeruajtës të NATO-s, KFOR, shihet si garanci për sigurinë e Kosovës.

Phillips paralajmëron pasojë të konsiderueshme në këtë aspekt nëse Trumpi rizgjidhet. "Një nga gjërat e para që Trump do të bëjë është vlerësimi i politikës amerikane dhe i interesave të sigurisë. Unë do të prisja që [baza ushtarake amerikane në Kosovë] Bondsteel të eliminohej gradualisht. Gjithashtu, çdo hap për ta futur Kosovën në NATO do të pezullohej", thotë Phillips.

Wisner argumenton se forcat amerikane përmbushin një rol të dyfishtë në Kosovë, duke vepruar jo vetëm si mbrojtëse, por edhe si simbol i angazhimit të ShBA-së. "Nuk është mirë të mendosh se çështjet e kësaj natyre zgjasin përgjithmonë. Por, duke pasur parasysh gjendjen e pazgjidhur të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, shpresoj se trupat amerikane do të vazhdojnë të jenë pjesë e regjimit të sigurisë në të cilin jeton Kosova", thotë Wisner.

Mendimet e disa qytetarëve të

anketuar nga Radio Evropa e Lirë në Prishtinë përputhen ngushtë me ato të analistëve. Shumica besojnë se presidenca e Harrisit, ndryshe nga ajo e Trumpit, do ta ruante frymën e stabilitetit. "Unë mendoj se Harris do të ishte më mirë. Edhe për Kosovën, mendoj se do të ishte më mirë. Do të na ndihmonte, sepse ne kemi nevojë për ndihmë. Siç na ka ndihmuar Clintoni... Kurse Trumpi është më agresiv, ma merr mendja se nuk do t'i ndihmonte Kosovës", thotë Naser Leci.

Vjosa Thaçi beson se "zgjedhjet do të fitohen nga Trumpi". "Edhe pse Harris është kandidatë më e preferuar për ne shqiptarët, për faktin se ajo i përket partisë tradicionale që ne shqiptarët e Kosovës e përkrahim gjithmonë" por, sipas saj, "[Harris] është treguar më e mirë për popullin, për ekonominë amerikane, për multipolaritetin që ka Amerika. Harrisin nuk ka treguar refuzim ndaj komuniteteve të tjera, sikurse Trumpi është kundër të huajve dhe kërkon sanksione ndaj tyre. Edhe ndaj botës [Harris] më duket se ka një qëndrim më liberal", thotë Bujar Tresi.

Me një kandidatë që nuk e ka pasur Kosovën në portofolin e saj të karrierës dhe me një kandidat të paparashikueshëm në vendime, mbetet e paqartë nëse Kosova do të vazhdojë të ketë një aleat konstruktiv në ShBA, apo do të përballet me pengesa të reja. Gara mes tyre është tejet e ngushtë.

Me fjalët e ambasadorit Frank Wisner, Kosova duhet të ketë durim - të fokusohet në ngritjen e kapaciteteve ekonomike dhe përmirësimin e qeverisjes, pa pasur iluzione se do të njihet shpejt nga Serbia dhe do t'i hapen rrugët për integrim në BE a OKB.

Hoxhaj: Në Raportin e Progresit shihet se Kosova ka marrë vetëm obligime nga dialogu me Serbinë pa asnjë përfitim konkret

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Ish-ministri i Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj, ka thënë se kur e lexon Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, është për të ardhur keq që procesi i transformimit është ndalur dhe bllokuar, pasi gjatë viteve të fundit Kosova nuk ka pasur asnjë reformë të brendshme në asnjë sektor dhe asnjë sukses në politikën e jashtme. Sipas tij, Kosova ka marrë vetëm obligime nga dialogu me Serbinë, pa asnjë përfitim konkret dhe pa

mbështetje politike dhe financiare. “Në Raportin e Progresit thuhet qartë se Kosova nuk pritet ta marrë statusin e kandidatit në një kohë të afërt. Pas aplikimit në dhjetorin e vitit 2022, kërkesa e Kosovës nuk është trajtuar fare në Bruksel, as me shkrim dhe as me ndonjë zotim politik joformal! Raporti thekson se Kosova duhet ta zbatojë Marrëveshjen e Brukselit dhe Aneksin e Ohrit. Gjithashtu, theksohet qartë se propozimi evropian për Asociacionin është çështje e përfunduar për BE-në dhe Kosova vetëm duhet ta zbatojë atë. Ajo që përmban teksti i raportit është mjaft

shqetësuese, ku thuhet: ‘Si Kosova ashtu edhe Serbia pritet t’i zbatojnë obligimet e tyre përkatëse që rrjedhin nga Marrëveshja për rrugën drejt normalizimit. Kjo përfshin themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe (A/CSM). Kosova pritet ta nisë procesin që çon në krijimin e A/CSM bazuar në propozimin evropian të paraqitur palëve më 21 tetor 2023. Serbia pritet të fillojë t’i përmbushë detyrimet nga Marrëveshja paralelisht duke iniciuar njohjen e dokumenteve, simboleve dhe institucioneve të Kosovës’. Nga ky paragraf



kuptohet qartë që Marrëveshja e Brukselit dhe Asociacioni janë në fuqi, dhe përtej debatit të

nënshkrimit dhe zbatimit, të gjitha këto janë në fuqi”, ka shkruar Hoxhaj në “Facebook”.

Shqiptarët e Luginës protestojnë kundër pasivizimit të adresave

MEDVEGJE, 3 NËNTOR - Me thirrjet “Kthema adresën”, shqiptarët e Luginës së Preshevës kanë protestuar të dielën për herë të tretë brenda pak muajve kundër atyre që i quajnë veprime diskriminuuese të autoriteteve serbe ndaj pakicës shqiptare në Serbi.

Të dielën protestuesit janë mbledhur para Stacionit të Policisë në Medvegje.

Në Serbi jetojnë më shumë se 60 000 shqiptarë, të cilët përbëjnë pakicën e katërt më të madhe atje, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë më 2022.

Në raportet ndërkombëtare, Lugina e Preshevës - term që përdoret për Preshevën, Medvegjën dhe Bujanocin, komuna të banuara me shumicë shqiptare në jug të Serbisë konsiderohet tërësisht e izoluar dhe thuhet se merr vëmendje vetëm në kohë zgjedhjesh.

Në protestën e së dielës ka marrë pjesë deputeti i vetëm shqiptar në Kuvendin e Serbisë, Shaip Kamberi, më pas kryetarja e Preshevës, Ardita Sinani dhe pjesëtarë të Këshillit Kombëtar Shqiptar, organit përfaqësues të pakicës shqiptare në Serbi.

Kur është pyetur për t’i komentuar protestat paraprake, presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, pati thënë se “askush nuk po i rrah, nuk po i ngacmon, apo



diçka tjetër. Serbia është shtet demokratik dhe ne do të vazhdojmë të sillemi në këtë mënyrë”.

Në protestat e mbajtura, fillimisht në Bujanoc, e më pas në Preshevë, u bë thirrje për njohje të diplomave të Kosovës, për integrim nëpër institucionet shtetërore të Serbisë, për lejim të përdorimit të simboleve

kombëtare shqiptare dhe për zgjidhjen e çështjes së pasivizimit të adresave.

Pasivizimi nënkupton fshirjen e qytetarëve prej adresave ku kanë qenë të regjistruar. Ky hap rezulton me humbjen e shtetësisë serbe, rrjedhimisht të të gjitha të drejtave civile - përfshirë të drejtën për të votuar, për të pasur pronë, për

të pasur sigurim shëndetësor e pension dhe për t’u punësuar. Pasivizimi i adresës përcaktohet me ligj në Serbi prej vitit 2011. Ligji parasheh që institucionet të bëjnë kontrolle për të kuptuar nëse një banor jeton në adresën e regjistruar.

Nëse vërtetohet që një banor nuk jeton në atë adresë, merret vendimi për pasivizimin e saj,

dhe banori obligohet ta regjistrojë adresën e re brenda tetë ditëve pas pranimit të vendimit.

Ndonëse ligji parasheh të drejtën për apel, qytetarët kanë thënë se, në disa raste, as nuk kanë mundur të ankohen ndaj vendimit, pasi nuk janë informuar me kohë për pasivizimin.

Në raportin e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat të Njeriut në Serbi, të vitit 2021, Presheva, Medvegja dhe Bujanoci përshkruhen si pengje të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Sipas raportit, çështja e pasivizimit të adresave “në thelb është formë e spastrimit etnik nëpërmjet metodave administrative”.

Banorët e Luginës dhe udhëheqës të komunave atje kanë kërkuar disa herë që të ketë prani të mekanizmave ndërkombëtarë në mënyrë që të monitorohen kushtet e jetesës në atë pjesë. Ata i kanë akuzuar përfaqësuesit e faktorit ndërkombëtar në Beograd për mosreagim ndaj trajtimit që u bëhet.

Mungesa e investimeve dhe barrierat e vazhdueshme besohet se kanë ndikuar në largimin e rreth 20 000 shqiptarëve prej këtij rajoni, kryesisht drejt shtetit të Kosovës.

Hamza publikon fotografi me gruan dhe fëmijët: Familja jonë e madhe është Kosova

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, ka publikuar të dielën në “Facebook” një fotografi bashkë me anëtarët e familjes. Ai i ka

falënderuar ata që i kanë qëndruar pranë, që e kanë kuptuar dhe mbështetur në secilin hap.

Hamza ka thënë se familja është frymëzimi i tij dhe postimin e

ka përmbyllur duke thënë se Kosova është “familja jonë e madhe”. “Familja! I falënderoj shumë Remën, Tinën, Djellzën dhe Ensarin, që më kanë qëndruar pranë, më

kanë kuptuar dhe më kanë mbështetur, në çdo hap. Janë frymëzimi dhe forca ime e përditshme. Familja jonë e madhe është Kosova!”, ka shkruar Hamza.





PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (PDK) KA SHPALOSUR SLOGANIN DHE PROGRAMIN QEVERISËS: "KOSOVA MUNDËT MA MIRË"

Me Bedri Hamzën kryeministër "Kosova mundet ma mirë"

"Pagat në sektorin publik do të rriten 50 % për shërbyesit civilë, mjekët, infermierët, mësuesit, profesorët, zjarrfikësit, ushtarët, policët e të gjithë ata që marrin rroga nga buxheti i shtetit", ka thënë Bedri Hamza

Kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, ka shpalosur sloganin e fushatës për zgjedhjet e 9 shkurtit "Kosova mundet ma mirë". Ai ka paraqitur platformën përmes së cilës, ndër të tjera, do t'i përmbushë pesë qëllime: zhvillimin ekonomik të vendit, rritjen e pagave dhe pensioneve, përgatitjen e të rinjve për tregun e punës përmes investimeve në arsim, përmirësimin e sistemit shëndetësor, raportet e mira me aleatët

por një njeri të vendosur për ta bërë vendin tonë më të fortë, më krenar dhe më të mirë. Prandaj, Bedri Hamza e meriton mbështetjen tonë, sepse Kosova ka nevojë për Bedri Hamzën", theksoi lideri i PDK-së.

Krasniqi tha se Partia Demokratike e Kosovës po e nis një epokë të re, vizionin për të ndërtuar një të ardhme që sjell mundësi të reja dhe një jetë më të mirë për çdo familje në vendin tonë. "Kosova meriton shkolla më të mira, spitale më të mira, institucione dhe shërbime më të mira, paga dhe pensione më të mira, punë dhe mundësi më të mira për secilin qytetar, për secilin të ri e të re që dëshiron ta ndërtojë jetën e të krijojë familje në atdheun tonë. Gjendja e vështirë në të cilën jemi tani nuk guxon të na e përcaktojë të ardhmen. Askush nuk mund ta shkruajë fatin tonë për ne, sepse ne vetë duhet ta shkruajmë vetë fatin tonë. Ju

jeni ata që duhet vetë ta përcaktoni të ardhmen tuaj. E bashkë, kështu siç jemi sonte dhe me kryeministrin Bedri Hamza, kjo është e arritshme", tha kreu i PDK-së. Krasniqi tha se PDK-ja është testamenti i qëndrueshmërisë, i adaptimit dhe i ndryshimit për të mirën e vendit, sepse është histori që flet për njerëzit që nuk u dorëzuan e nuk u ndalën kurrë. "Kemi pasur fatin e madh që përgjatë viteve, në krye të kemi dy personalitete, të cilët gjithmonë kanë qenë të hapur e të guximshëm, që ndryshimin e nevojshëm, ta nisnin duke filluar nga vetja. E duke e bërë veten më të mirë, këta dy e kanë bërë partinë më të mirë, e kanë bërë Kosovën më të mirë. Kjo, para së gjithash, tregon se PDK-ja nuk është një parti rigjide dhe e palëvizshme, por një parti që ndryshon dhe u adaptohet sfidave dhe kërkesave të kohës. Prandaj, sonte, këtu, të gjithë së bashku, i nderojmë

udhëheqësit, liderët e shtetit dhe të partisë tonë, presidentin Hashim Thaçi dhe kryetarin Kadri Veseli", shtoi ai.

Ndërkaq kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, shpalosi sloganin e fushatës për zgjedhjet e 9 shkurtit. "Nëse ka një mesazh që dua ta merrni të gjithë ju nga kjo konventë, është bindja jonë se Kosova mundet ma mirë. Ky është edhe slogani i fushatës sonë 'Kosova mundet ma mirë'. Ne jemi këtu për ta dëshmuar këtë. Ndërsa unë si kryeministër, ju siguroj se do ta bëj këtë", tha Hamza.

Kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, ka paraqitur platformën përmes së cilës, ndër të tjera, do t'i përmbushë pesë qëllime: zhvillimin ekonomik të vendit, rritjen e pagave dhe pensioneve, përgatitjen e të rinjve për tregun e punës përmes investimeve në arsim, përmirësimin e sistemit shëndetësor, raportet e mira

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Partia Demokratike e Kosovës e ka mbajtur konventën në mbështetje të Bedri Hamzës, kandidatit të saj për kryeministër.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, në këtë konventë ka thënë se Kosovës i duhet një qeveri që i shërben, e mbron dhe e fuqizon popullin e vet në secilën fushë.

Krasniqi tha se Bedri Hamza

Katër vjet nga arrestimi i ish-krerëve të UÇK-së, a po i vjen fundi gjyqimit të madh në Hagë?

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Fundi i vitit të ardhshëm ose fillimi i 2026-s mund ta shënojë përfundimin e procesit gjyqësor ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilët Zyra e Prokurorit të Specializuar i akuzon për krime të pretenduara të luftës, vlerësojnë monitoruesit e këtij procesi.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi ndodhen në paraburgim në Hagë - qyteti holandez ku Gjykata Speciale e ka selinë që prej nëntorit të vitit 2020.

Numri i dëshmitarëve të prokurorisë në atë që njihet si gjykimi i madh ka mbërritur njëqindëshin. Prokuroria atje ka hequr dorë nga dëgjimi i disa dëshmitarëve dhe i ka pranuar disa dëshmi me shkrim.

Të premtën, më 1 nëntor, ZPS njoftoi se nuk do të mbështetet më në dëshmitë e dymbëdhjetë dëshmitarëve. Gjithashtu, u bë me dije se ZPS-ja do t'i paraqesë deklaratat e tetë dëshmitarëve me shkrim në vend të dëshmimeve të drejtpërdrejta në gjykatë.

Çështja e ZPS-së është paraparë të mbyllet në prill të vitit të ardhshëm, për t'i hapur pastaj rrugë asaj të mbrojtjes. Avokatët në Kosovë dhe monitoruesit vlerësojnë se ky proces është tejzgjatur.

Artan Çerkini, avokat i akredituar nga Specialja, thotë për "KosovaPress" se ka hapësirë për reduktim më të madh të numrit të dëshmitarëve. "Me sa jam në njohuri, janë larguar 11 dëshmitarë me kërkesën e Prokurorisë së Specializuar. Natyrisht se kjo do të ndikojë në masë të konsiderueshme, nuk mund të them në masë të madhe, në shpejtimin e procedurës, pasi që edhe dëgjimi i dëshmitarit merr kohë dhe nëse prokuroria heq dorë nga dëgjimi i dëshmitarit, kjo nënkupton se koha për paraqitjen e provave te prokuroria do të jetë më e shkurtër dhe, për rrjedhojë, edhe procedura do të jetë më e efikasë. Konsideroj se këtu ka hapësirë ende të reduktohet numri i dëshmitarëve ngase gjykata

duhet të kujdeset për zbatimin e gjyqimit brenda një afati të arsyeshëm. Ndërsa tani e katër vjet të pandehurit janë në paraburgim pa vendim gjyqësor të formës së prerë për fajësinë e tyre. Nëse mbrojtja nuk ka shumë prova për të prezantuar, atëherë fillimi i vitit 2026 mund të jetë një kohë e arritshme për të pasur një epilog gjykimi në shkallë të parë", shprehet avokati Çerkini.

Duke folur për këtë proces, monitoruesi nga Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë, Amer Alija, beson që deri në fund të vitit të ardhshëm ndaj ish-krerëve të UÇK-së do të ketë një vendim të prerë të shkallës së parë. "Del që pjesërisht apo tërësisht 50 % e dëshmitarëve të propozuar nga Prokuroria deri në këtë moment, kanë dhënë dëshmi nëpër seanca të mbyllura. Sigurisht që procesi është duke shkuar kah fundi, por sigurisht që do të marrë kohë edhe pjesa e mbrojtjes se sa do të jetë numri i dëshmitarëve që do të dëgjohet. Në rast se vazhdojmë me këtë

ritëm dhe me këto kufizime që i ka dhënë trupi gjyqësor, unë pres që kah fundi i vitit të ardhshëm mund të ketë një vendim të shkallës së parë, por çdo gjë varet nga propozimet, numri i dëshmitarëve, nga provat të cilat do të administrohen gjatë shqyrtimit kryesor. Besoj që sa më shpejt që të kryhet ky proces, është më mirë edhe për palët në procedurë për arsye se të akuzuarit që disa vjet janë duke u mbajtur në masën e sigurisë të paraburgimit dhe sigurisht që jo çdoherë është e rekomandueshme të aplikohet masa e paraburgimit kur ekzistojnë edhe masat më të buta. Por, sigurisht që këto kushte të caktimit të masës gjithmonë i vlerëson trupi gjyqësor", thotë Alija.

E Astrit Kolaj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, thotë për "KosovaPress" se shkurtimi i kohëzgjatjes së këtij procesi gjyqësor nuk duhet t'i dëmtojë palët në procedurë. "Tani prokuroria është duke marrë

veprime të cilat dërgojnë në një përfundim të procesit më shpejt, ka vepruar në dy drejtime duke u tërhequr nga dëshmia një pjesë e dëshmitarëve dhe një pjesë e dëshmitarëve të tjerë është duke i deponuar dhe ka deponuar dëshmi me shkrim dhe nuk do të ftohen ata që të jenë pjesë e dëshmisë drejtpërdrejt. Sa më shumë që është e mundur të shkurtohet koha e përfundimit të procesit, mirëpo në asnjë mënyrë që mos të vepronet me qëllim të shkurtimit të kohës e në anën tjetër të dëmtohen palët në procedurë dhe të kemi një shkelje të palëve në procedurë vetëm me qëllim që të shkurtohen afatet për përfundimin e gjyqimeve", thotë ai.

Një pjesë e madhe e këtij procesi gjyqësor ka kaluar në seanca të mbyllura për publikun dhe me dëshmitarë të mbrojtur. Gjykimi ndaj Thaçit dhe të tjerëve nisi në prill të vitit 2023. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha akuzat.



me aleatët, duke synuar anëtarësimin në OKB dhe integrimin e përsheptuar në NATO dhe Bashkimin Evropian, me lidhje të forta me pjesët e tjera të kombit shqiptar. "Pagat në sektorin publik do të rriten 50 % për shërbyesit civilë, mjekët, infermierët, mësuesit, profesorët, zjarrfikësit, ushtarët, policët e të gjithë ata që marrin rroga nga buxheti i

shtetit. Për dallim, për pozitat me paga të larta dhe emërime politike, rritja do të jetë 30 %. Për sa iu përket pensioneve, në qeverinë time nuk do të ketë pension më të ulët se 200 euro", ka thënë Hamza.

Hamza ka treguar se do të ofrojë subvencione prej 100 eurosh në muaj për familjet që nuk mund t'i regjistrojnë fëmijët në çerdhe publike dhe i regjistrojnë ata në çerdhe

private, duke siguruar kështu mundësi më të përbalueshme dhe të qasshme për kujdesin ndaj fëmijëve. "Çdo qytetar i Kosovës, i ri apo i vjetër, do të ndihet i vlerësuar dhe i mbështetur nga shteti. Ky është një borxh i kahershëm për qytetarët tanë. Ne do ta përmbushim këtë obligim pa vonesa. Transparenca dhe llogaridhënia nuk duhet të mbeten vetëm fjalë. Për mua,

ato kanë qenë dhe mbesin udhërrëfyes i punës sime", u zotua Hamza.

Ai i ka ftuar të gjithë qytetarët që ta mbështesin, duke u angazhuar për realizimin e vizionit për ta bërë Kosovën më mirë. "Ne të gjithë mund të bëhemi më të mirë në shumë mënyra. Mund të bëhemi zyrtarë më të mirë, punëtorë më të mirë, punëdhënës më të mirë, mësues më të mirë,

prindër më të mirë, studentë më të mirë. Dua që të gjithë ju të besoni se Kosovën mund ta bëjmë më të mirë", tha Hamza. Në këtë konventë u shfaq një video e shkurtër për ish-liderët e PDK-së, Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli, një video përmbledhëse e punëtorive të Bedri Hamzës me qytetarët nëpër komuna, si dhe një video me qytetarë që kërkojnë një të ardhme më të mirë në Kosovë.

Përparësitë e Kosovës nëse Kamala Harris fiton zgjedhjet më 5 nëntor



Shkruan:
Prof. Dr. Fejzulla
BERISHA

Nëse Kamala Harris fiton zgjedhjet presidenciale të vitit 2024, pritet që qasja e saj ndaj Kosovës ta vazhdojë politikën e administratës Biden, duke theksuar rëndësinë e stabilitetit

në Ballkanin Perëndimor, integrimin evropian të rajonit dhe ruajtjen e një pranie të fortë amerikane dhe të NATO-s. Kjo qasje dallon nga politika më e paqëndrueshme e ish-administratës Trump dhe përfshin disa aspekte kyçe, të diskutuara nga analistë dhe ish-diplomatë amerikanë: Ruajtja e pranisë së trupave KFOR. Si pjesë e një administrate që mbështet NATO-n, Harris do të synojë ruajtjen e pranisë amerikane në Kosovë përmes trupave KFOR, të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e stabilitetit dhe parandalimin e

përkallëzimeve midis Kosovës dhe Serbisë. Ndryshe nga ish-Presidenti Trump, i cili kishte kërcënuar të tërhiqte trupat nëse Kosova nuk përmbushte kërkesat e tij në dialogun me Serbinë dhe kritikonte NATO-n për mosarritjen e objektivave të shpenzimeve ushtarake, një administratë Harris pritet të jetë më mbështetëse për Kosovën. Qëndrim më kritik ndaj Serbisë Ekspertë si Edward Joseph dhe ish-diplomati Shaun Byrnes kanë kritikuar administratën Biden për "zbutje" të qasjes ndaj Beogradit, duke theksuar lidhjet e ngushta të Serbisë me Rusinë dhe ndikimin destabilizues që

kjo mund të ketë. Harris pritet të adoptojë një qëndrim më kritik ndaj Serbisë dhe të shtojë presionin për njohjen e Kosovës dhe integrimin e saj në struktura ndërkombëtare më të fuqishme. Një administratë Harris pritet të përfshijë një qasje që përqendrohet në mbështetjen për demokracinë dhe të drejtat e njeriut - një filozofi e zakonshme e politikës së jashtme të Demokratëve. Për një shtet si Kosova, që përballet me sfida të demokracisë dhe tensione etnike, kjo qasje do të ishte një mbështetje e rëndësishme. Gjithashtu, Harris

ka të ngjarë të refuzojë propozimet për shkëmbime terriroresh, të mbështetura më herët nga ish-administrata Trump. Përfshirja e BE-së në dialogun Kosovë - Serbi Harris dhe administrata e saj pritet të forcojnë marrëdhëniet me Bashkimin Evropian dhe të mbështesin përfshirjen e BE-së në dialogun Kosovë-Serbi. Ndryshe nga administrata Trump, e cila shpesh minimizonte rolin e BE-së, administrata Biden ka ruajtur këtë qasje, duke e konsideruar BE-në si partner kyç. Diplomacia shumëpalëshe do të synojë një qasje të unifikuar.

Mbi 100 organizata të shoqërisë civile nga Ballkani kërkojnë përfshirjen e Kosovës në ECMI

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Rrjeti Ballkanik për Zhvillim të Shoqërisë Civile (BCSDN), anëtar i së cilës është Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), ka dorëzuar letrën e nënshkruar nga mbi 100 organizata të shoqërisë civile nga Ballkani në Këshillin Ekonomik dhe Social të BE-së (KEES/EESC), me kërkesën për përfshirjen e Kosovës në Iniciativën për Anëtarë nga Vendet Kandidate të Zgjerimit (ECMI), si dhe vazhdimin e kësaj iniciative edhe pas fazës pilot. Në fillim të këtij viti, Këshilli Ekonomik dhe Social i Bashkimit Evropian, si institucion përgjegjës i BE-së për përfshirjen e partnerëve socialë nga sektori i punëdhënësve, punëmarrësve dhe organizatave të shoqërisë civile, pati lansuar këtë pilotprojekt të përfshirjes të përfaqësuesve të këtyre



sektorëve nga vendet e zgjerimit të cilat ende nuk janë shtete anëtare të BE-së, duke lënë jashtë kësaj nisme vetëm Kosovën. KCSF ka përcjellë me vëmendje

zhvillimet në kuadër të kësaj nisme dhe në prill të këtij viti kishte nisur reagimin në kuadër të BCSDN-së, pasi që Këshilli Ekonomik dhe Social vendosi ta përdorë kornizën e vendeve me

status të vendit kandidat si kriter bazë për kualifikueshmërinë e përfshirjes në këtë nismë. Kjo kornizë bëri që Kosova të mbetet vendi i vetëm me perspektivë të

anëtarësimit në BE që nuk përfshihet në këtë nismë. Duke e konsideruar këtë vendim të Këshillit Ekonomik dhe Social si të gabuar dhe në kundërshtim me vet vlerat dhe parimet që promovohen nga ky institucion i BE-së, KCSF bashkë me përfaqësues të tjerë të shoqërisë civile dhe sindikatave nga Kosova më 24 maj 2024 ka pasur takim me udhëheqës të KEES/EESC ku është shprehur shqetësimi për mospërfshirje të Kosovës dhe është kërkuar korrigjimi i këtij vendimi. Për më tepër, e njëjta kërkesë është përsëritur edhe në Konferencën e Nivelit të Lartë për shoqërinë civile që u zhvillua në Bruksel nga Këshilli Ekonomik dhe Social i BE-së më 24 tetor 2024. KCSF vlerëson se përfshirja e Kosovës në këtë nismë është thelbësore për një bashkëpunim më të fortë rajonal dhe për ta mbështetur rrugën tonë të përbashkët drejt integritit evropian.

Zef Morina rizgjedhet kryetar i PShDK-së, akuzon Kurtin se e ka katandisur vendin

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Bashkëpunimi Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Partisë Shqiptare Demokratike të Kosovës do të ndikojë në ngritjen dhe forcimin e institucioneve të vendit për një Kosovë më të begatë dhe më të shëndoshë. Kështu është theksuar nga përfaqësuesit e këtyre partive në Kuvendin e njëmbëdhjetë zgjedhor të PShDK-së, në të cilën Zef Morina është zgjedhur për të dytin mandat kryetari i kësaj partie, si dhe Këshilli i Përgjithshëm. Kryetari i Partisë Shqiptare

Demokristiane të Kosovës, Zef Morina, ka treguar platformën dhe pikëpamjet lidhur me rrugëtimin, ringritjen dhe zgjerimin e këtij subjekti politik në katër vitet e ardhshme. Ai ka deklaruar se PShDK, bashkë me LDK-në, do të ndërmarin reforma të mëdha, veçanërisht në ekonomi, shëndetësi, arsim dhe drejtësi, ashtu që qytetarët e Kosovës të mos kenë shportën gjysmë të mbushur për familjet e tyre. Derisa u shpreh se Republika e Kosovës rrezikohet nga një e keqe më e madhe që është izolimi ndërkombëtar i vendit, theksoi se

vetëm riorganizimi dhe ringritja e të djathtës shqiptare e udhëhequr nga koalicioni LDK-PShDK do të mund ta kthejë Kosovën në rrugën e zhvillimit ekonomik, arsimor, shëndetësor dhe të riintegrojë si dikur raportet të shkëlqyera me bazën perëndimore. "Do të fillojmë menjëherë përgatitjet intensive për zgjedhjet e 9 shkurtit 2025, ashtu që edhe ne ta japim kontributin tonë maksimal që Kosova ta ndalë rrugëtimin e gabuar, të cilin e kanë katandisur kryeministri dhe qeveria aktuale", ka thënë Morina.



Rritja e turizmit në Shqipëri: Çfarë tregojnë të dhënat?

TIRANË, 3 NËNTOR - Plazhet, malet, qytetet, trashëgimia kulturore, çmimet...

Dhjetëra miliona turistë të huaj kanë vizituar Shqipërinë në vitet e fundit për arsye të ndryshme. Vetëm gjatë tetë muajve të parë të këtij viti Shqipërinë e vizituan mbi 8.5 milionë të huaj.

Trendi i rritjes së vizitorëve të huaj kishte nisur në vitet para pandemisë Covid-19, që goditi Shqipërinë dhe vendet përreth në pranverën e vitit 2020.

Atë vit numri i turistëve ra ndjeshëm shkak të kufizimeve të rrepta në udhëtime, në tentim për ta limituar përhapjen e Covid-19. Por, që atëherë, turizmi në Shqipëri është ngjallur sërish.

Sipas një raporti të publikuar nga Organizata Botërore për Turizëm e Kombeve të Bashkuara (UNWTO), në fund të muajit të kaluar Shqipëria është vendi i dytë në botë që ka pasur rritjen më të madhe të turizmit.

Në krahasim me periudhën janar-korrik të vitit 2019 - para pandemisë Covid-19 - Shqipëria ka pritur 93 për qind më shumë turistë gjatë së njëjtës periudhë

të vitit 2024.

Vetëm Katarri gëzon rritje më të madhe se ajo.

Kjo rritje e turizmit ka bërë që Shqipëria të arkëtojë edhe më shumë fitime. I njëjti raport i UNWTO-së e rendit Shqipërinë si vendin me rritjen më të madhe në botë të arkëtimeve nga turizmi.

Në krahasim me vitin 2019, Shqipërinë këtë vit e kanë vizituar dukshëm më shumë banorë nga Evropa Jugore - plot 3.1 milionë turistë më shumë.

Ndërsa rajonet e vetme prej ku ka pasur rënie të numrit të turistëve, janë Azia Lindore dhe Paqësori, si dhe Afrika.

Numri më i madh i këtyre vizitave bëhet gjatë muajve të verës. Vetëm gjatë muajve qershor, korrik dhe gusht të këtij viti Shqipërinë e vizituan mbi 5 milionë të huaj. Edhe në vitet paraprake, muajt e verës kishin tërhequr më së shumti të huaj në Shqipëri.

Gjatë këtyre muajve rritet edhe numri i udhëtarëve transitë, që kalojnë në Shqipëri vetëm për të shkuar në një destinacion tjetër final. Por, numri i këtyre



udhëtarëve është i ulët në krahasim me ata që udhëtojnë për arsye personale, për pushime dhe për vizita te të afërmit e tyre.

Gjatë tetëmujorit të parë të këtij

viti, si në çdo periudhë tjetër, Shqipëria priti më së shumti vizitorë nga Kosova fqinje, ndjekur nga Italia dhe Maqedonia e Veriut.

Edhe pse ende në numër

dukshëm më të vogël sesa turistët nga vendet fqinje, në vitin e fundit është rritur edhe numri i vizitorëve nga India, Kina, Franca dhe Holanda, krahasuar me vitin paraprak.

Raporti i KE-së për Kosovën: Probleme me tregun e punës dhe emigrim i lartë



PRISHTINË, 3 NËNTOR - Rezultatet e dobëta në tregun e punës, progres i kufizuar në infrastrukturë, kontratat

njëburimore, janë disa nga të gjeturat në fushën e ekonomisë në Raportin e Progresit për vitin 2024 të hartuar nga Komisioni Evropian për Kosovën.

Kritika për vendin tonë pati edhe për numrin e madh të të rinjve, që nuk ndjekin shkollimin e lartë ose trajnimet.

Sipas këtij raporti, ky numër ka shënuar rritje dhe është më i larti në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Përveç kësaj, në raport potencohet se rezultatet e dobëta të tregut të punës kontribuojnë në nivele të vazhdueshme të larta të emigrimit. "Tregu i punës vazhdon të vuajë nga pjesëmarrja shumë e ulët, papunësia e lartë dhe hendeqet

e mëdha gjinore. Në vitin 2023 pjesa e të rinjve (15-24 vjeç) jo në punësim, arsim apo trajnim u rrit në 33.4 %, nga 33 % në 2022, që është më i larti në Rajonin e Ballkanit Perëndimor. Rezultatet e dobëta të tregut të punës kontribuojnë në nivele të vazhdueshme të larta të emigrimit. Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore vazhdojnë të publikohen me vonesa të mëdha", thuhet në raport,

raporton "KosovaPress".

Përveç kësaj, në Raportin e Progresit thuhet se Kosova ka bërë përparim të kufizuar në përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore. Në raport thuhet se nuk ka pasur progres në autostradën Prishtinë - Merdar si dhe punimet rehabilituese për Linjën Hekurudhore 10 vazhduan me ritme të ngadalta. "Tenderimi i sistemet e sinjalizimit dhe

telekomunikacionit, që është me prioritet të madh, është ende i vonuar për shkak të mungesës së financimit. Sistemi i transportit ende përballet me disa sfida në aspektin e sigurisë, mirëmbajtje e pamjaftueshme dhe kapacitete të dobëta administrative të institucioneve rregullatore", thuhet në raport.

Vendi është qortuar edhe për numrin e madh të kontratave njëburimore (përdorimin e procedurave të negociuara të prokurimit) veçanërisht në Korporatën Energjetike të Kosovës. "Kosova duhet ta përmirësojë planifikimin e saj dhe ta reduktojë përdorimin e procedurave të negociuara të prokurimit. Për t'i reduktuar rreziqet e keqpërdorimit dhe mashtrimit, është e rëndësishme të sigurohet transparencë e plotë, me arsyetim të fortë që shpjegon vendimin për dhënien e çmimit dhe t'i mbajë gjurmët e auditimit. Në vitin 2023 procedurat e negociuara pa publikim të njoftimit të kontratës ishin 13.5 për qind, me një shumicë prej kontratave të lidhura nga Korporata Energjetike e Kosovës", thuhet në raport.

Në raport përmendet se sektori i shërbimeve vazhdoi ta dominojë aktivitetin ekonomik në vitin 2023, duke siguruar 46 % të brutoprodhimit vendor. Sipas raportit, rekomandimet e KE-së nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht.

Një udhëheqës vulgar dhe një kandidate e dobët: Amerika ka frikë nga të dy



“Asgjë në lidhje me të, nuk tregonte që një ditë do të bëhej prokurore e San Franciskos, prokurore e Kalifornisë, senatore, zëvendëspresidente”, tha për të miku i saj më i ngushtë i rinisë, Matthew Davis, avokat. Dhe sot në lidhje me të, saj nuk sugjeron se do të bëhet presidente.

Jo për shkak të zërit të saj, të cilin shumë e konsiderojnë të pakëndshëm. As për të qeshurën, me të cilën bëjnë shaka kundërshtarët. As për gjatësinë, që duket qartë më pak se 1,64 metrat e deklaruar. As për historinë e saj, nga e cila vërtet vjen një mesazh shprese. Fushata e Harris nuk merr hov për një arsye shumë të thjeshtë.

Donald Trump ka konfirmuar ditët e fundit se është ai që është. Një burrë agresiv, i vrazhdë, me një vulgaritet revolutes, që ngre një tubim përreth madhësisë së burrërisë së një kampioni golfi, i cili gjithashtu vdekur, që imiton një marrëdhënie orale për të rindezur një mikrofon që nuk funksionon, që thërret togat e ekzekutimit për kundërshtarët e tij. Mund të hartohen dhjetëra ese mbi defektet e Trump, nga ato që mbushin libraritë e Amerikës.

Të martën mbrëma, çfarëdo që të ndodhë, Trump do të shpallë se ka fituar: nëse e ka bërë vërtet, gjithçka do të përfundojë aty; nëse në realitet humbet, do të fillojë një periudhë e zjarrtë urrejtjeje që do ta ndajë dhe dobësojë edhe më shumë Amerikën.

Megjithatë, Donald Trump, na pëlqen apo jo, është një lider. Kamala Harris, jo! Dhe nëse nuk je lider, nuk bëhesh në njëqind ditë fushatë elektorale; aq më tepër nëse ke katër vite aspak emocionuese në Shtëpinë e Bardhë, si zëvendëse e Bidenit.

Jo vetëm kaq; Ka një lëvizje prapa Trumpit. I neveritshëm, egoist, izolues, ndonjëherë haptazi racist dhe puçist, por ka një mbështetje popullore që mund të shihet qartë. Prapa Kamalas ka një aleancë të përkohshme klanesh që nuk e duan njëri-tjetrin – Clintonët dhe Obamat -, të pakicave që e urrejnë njëra-tjetrën – hebrenjtë dhe muslimanët – ose injorojnë njëri-tjetrin – zezakët dhe latinët -, të grupeve sociale – nga gratë me diploma tek homoseksualët – të cilat nuk kanë asnjë arsye të veçantë

për të votuar për Harris, përveç se nuk e duan Trumpin.

Pensilvania vendimtare

Të jemi të qartë: loja është e hapur. Sondazhet e fundit nuk llogariten shumë: në të gjitha shtetet e luhatshme diferenca është nën kufirin e gabimit. Përshtypja është se Trump është përpara në Jug – Georgia, Arizona, ndoshta edhe Karolina e Veriut – dhe se Harris mund të mbajë Michiganin dhe Wisconsinin. Në fund gjithçka do të vendoset në Pensilvani.

Në shkallët e Rocky-t, atje ku “hamshori italian” stërvitej për përleshjet e tij të përgjakshme, po ngrënë skenën për mbylljen e fushatës së Kamalës. Do të ketë një koncert: deri më tani për të kanë kënduar Stevie Wonder, Beyoncé, Eminem, Jennifer Lopez dhe Bruce Springsteen, i cili ka luajtur me kitarë për kandidatët demokratë që nga shekulli i kaluar. Dje ishte Michelle Obama, pardje burri i Kamalas, Douglas Emhoff: një zotëri i ndrojtur dhe i sjellshëm, i detyruar të improvizonte tubime në periferinë më të varfër të

Amerikës.

Filadelfia, qyteti i shpalljes së pavarësisë, ka qenë prej kohësh më i populluari në Shtetet e Bashkuara; dhe e parë nga restoranti në katin e gjashtëdhjetë të Four Seasons, ku klientët janë të gjithë rreptësisht të bardhë dhe kamarierët të gjithë të zinj, Filadelfia duket si një tabelë shahu elegante e rrugëve të drejta, me rrokaqiejt përgjatë Delaware dhe kullën me Liberty Bell, simbol i Revolucionit Amerikan.

E parë nga poshtë, në çdo cep të trotuarit është një djalë i shtrirë duke fjetur, ose duke u tundur, ose duke folur me vete. Nuk ka nevojë të shkosh në “Fentanyl Walmart”, nënkalimin e Kensington Avenue ku tërbohet tregu më i madh i drogës në bregun lindor, i frekuentuar nga shpërndarës, klientë dhe prindër që ngrënë kapuçët e xhupeve në kërkim të fëmijëve të tyre. Të droguarit dhe të dëbuarit janë kudo, dhe ajo që bie në sy është se këto nuk janë banda: secili prej tyre është vetëm.

I njëjti rregull vlen edhe për ekonominë në kohën e Bidenit. E parë nga ekonomistët, nuk ka shkuar

kurrë kaq mirë: punësimi rekord, inflacioni në rënie. Parë me sytë e jetës së përditshme, Amerika pas Covid-it shfaqet e varfër dhe e ndarë: gjithçka kushton dyfish, ndonjëherë trefish; ish klasa e mesme vuan shumë; buzëqeshjet proverbiale të amerikanëve janë gjithnjë e më të rralla, dhe jo vetëm sepse ata shpesh hapin gojën pa dhëmbë (një trajtim i kanalit të rrënjës kushton tre mijë dollarë).

Hyrja në muze, në shkallët e Rocky-t dhe mitingu i fundit i Kamalas kushton 30 dollarë; ndoshta kjo është arsyeja pse nuk ka as edhe një vizitor të vetëm përballë Masaccios dhe Botticelisit të bukur. Nuk i duket as edhe dezurnit, një emigrant nga Shqipëria, i cili bisedon me ne me në italishten që ka mësuar prej televizorit, në vitet 1980: «Shpresoj që Kamala të humbasë. Pse? Sepse ajo është komuniste”.

Alarmi Kamala

E vështirë për t’u kuptuar për ne evropianët, që – me përjashtim të sovranistëve më të zjarrtë – e njohim mirë frikën nga Trump, gati të na braktisë në duart e Putinit

("nëse nuk paguani më shumë për NATO-n, nuk do t'ju mbroj, përkundrazi do t'i them mikut tim Vladimir të bëjë çfarë të dojë me ju.") Dhe me të vërtetë, frika dhe përbuzja për Trump janë të përhapura edhe në Amerikë. Por frika nga Kamala është po aq e fortë.

I rritur në qytetin më liberal, San Francisko, Harris nuk ka profilin e duhur për të pushtuar shtetet post-industriale si Pensilvania, ku klasat punëtore kërkojnë subvencione dhe mbrojtje, por janë pak të magjepsur, në mos të acaruar nga kultura e kalifornianëve të pasur.

Në fakt, i vetmi problem që nuk ka Kamala janë paratë. Fushata e saj ka mbledhur një miliard dollarë dhe tani ajo nuk di si t'i shpenzojë, reklammat duhej të rezervoheshin paraprakisht, madje ajo po i blen edhe tek Fox, rrjeti armik, me shpresën për të "peshkuar" republikanët e neveritur nga Trump.

Kamala ka një histori të bukur personale, në të cilën Obama pa një reflektim të vetin. Edhe pse ishte i fundit që e mbështeti pas tërheqjes së Biden, ai ka pasur gjithmonë një pikë të dobët për të, në të kaluarën e ka quajtur "prokurorja e përgjithshme më e bukur në vend". Por kjo nuk do të thotë se, në shtetet e luhatura, të qenit një grua

me ngjyrë, me një nënë indiane dhe një baba xhamajkan, është avantazh. Ajo u përpoq të pushtonte qendrën, të dërgonte mesazhe qetësuese për një Amerikë të caktuar. Por kur tha se flinte me armën në tryezën e saj pranë shtratit, ose falej dy herë në ditë, nuk dukej gjithmonë bindëse.

Babai i saj ishte një ekonomist marksist, nëna hindu e etnisë Tamile u dha vajzave të saj emrat e hyjnive. Kamala iu afrua kishës Baptiste. Kur Biden i telefonoi për t'i thënë "Unë po tërhiqem, është radha jote", gjëja e parë që ajo bëri, ishte t'i telefononte babait të saj shpirtëror, Reverend Brown, i cili i lexoi librin e Esterit, mbretëreshës që shpëton njerëzit nga shfarosja.

Trump është i njohur si një i pafe, me një jetë erotike shumëngjyrëshe: posterët e Harrisit i atribuojnë atij "34 sulme seksuale". Gazetari që e njuh më së miri, Michael Wolff, ka publikuar një fragment të regjistrimeve në të cilat Jeffrey Epstein, i cili kreu vetëvrasje në burg, vë bast me mikun e tij të madh Donald se cili nga të dy do të jetë në gjendje ta joshë Lady Dianën i pari. Megjithatë, me përjashtim të ungjillorëve që e konsiderojnë të tepruar, një pjesë e madhe e votës së krishterë do të shkojë për të, veçanërisht ajo katolike: e

vetmja lagje në Nju Jork ku ai ka një avantazh, Staten Island, është lagja e italo-amerikanëve.

Alarmi Trump

Fushata e tij kishte një bashkëprotagonist të shquar: Elon Musk. Trump kishte thënë të gjitha të këqijat e mundshme për të dhe makinat e tij elektrike. Pastaj Musk bleu Twitter dhe ia vuri në dispozicion, së bashku me shumë para. Trump e vlerësoi atë. Nëse një lider afrikan apo aziatik do të kishte vënë një milion në ditë për marrjen e votave të të pavendosurve, vëzhguesit amerikanë do t'i kishin anuluar zgjedhjet për mashtrim. Në fakt ideja e Musk u bllokua nga gjyqësori, por për ditë të tëra nuk flitej për asgjë tjetër. Disa pretendojnë se Musk nuk punon për Trump, por për veten e tij: nëse një milioner si Donald mund të bëhet president, pse një miliardër si Elon nuk mund të bëhet lideri i vërtetë i madh i së djathtës së re globale? Nuk është për t'u habitur që e djathta e vjetër e urren atë dhe Trump. Të gjithë kandidatët e fundit republikanë pak a shumë e mbështesin hapur Harrisin: familja McCain, Romney, Bush, Cheney. Trump tani tallet: «Çfarë do Cheney? Ai shkatërroi Lindjen e Mesme dhe tani po u kërkon

muslimanëve të votojnë për Kamalën? Nuk parashikoj sukses të madh".

Fushatat e urrejtjes së Trumpit kanë efekte shkatërruese, objektivat e tij duhet të paktën të largohen nga mediat sociale. Pas budallallëqeve për haitianët që hanë mace, iu desh të mbyllnin shkollat e fëmijëve të tyre, guvernatori republikan i Ohajos ndërhyri për t'i mbrojtur: "Haitianët janë punëtorë të mirë, ata nuk do ta gatuajnë kurrë kotelen tuaj".

Makina konspirative e Trump-it, pas së cilës New York Times sheh dorën e rusëve, prodhon çdo ditë një video padyshim false në të cilën shihen fletëvotimet me emrin e tij duke u shkatërruar ose votat elektronike për Trump që transformohen në vota për Harris. Dhe gjithsesi Makina e Filadelfias, makina demokratike, tashmë është vënë në lëvizje: në vitin 2012 bëri mrekulli, Romney raportoi se në 59 vende nuk kishte as një votë, vetëm një, për të; dje u njoftua se të gjitha votat me postë në Pensilvani do të gjykohej të rregullta, edhe ato që sistemi i konsideron të pavlefshme. Megjithatë, ndërsa largohemi nga qyteti, shenjat për Harrisin bëhen më të rralla dhe ato për Trump rriten. Në periferitë veriore ngritën edhe një statujë të saj, me një

gjilpërë të kuqërremtë: është e tmerrshme, por mund ta shihni nga larg, madje edhe nga treni për në Nju Jork.

Harris erdhi në Nju Jork për të takuar Trumpin të paktën dy herë, e para me mentorin e saj, presidentin e Parlamentit të Kalifornisë Willie Brown, e dyta për të marrë dy çeqe për fushatën elektorale si prokurorë. Trump siç dihet ka financuar demokratët prej një jete. Por këto janë detaje që nuk ndikojnë në votim. Po aq pak ndikim kanë dy luftërat, në Ukrainë dhe në Lindjen e Mesme: Trump, me lehtësinë e tij të njohur, premtori t'i ndalë të dyja; Fakti mbetet se Amerika e Biden-Harris ka krijuar përshtypjen se nuk është vendimtare në asnjërin nga të dyja. Tani demokratët do të duhet të qëndrojnë të palëkundur në luftën e tretë, e cila do të bëhet në shtëpi, me shpresë pa armë.

Sepse të martën në mbrëmje Trump do të pretendojë gjithsesi fitoren dhe nëse humbet, do të pretendojë mashtrime. Ai ende mund të mposhtet, nëse në orët e fundit Harris mobilizon amerikanët që nuk e duan atë. Ndërkohë, billboardi i ndritshëm në qendër të Filadelfias tregon se gjithnjë e më shumë po vihen baste për të. Në Uashington kanë forcuar gardhet rreth Shtëpisë së Bardhë. / Corriere della Sera – Bota.al





Drita e Prishtina me fitore të rëndësishme

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Drita dhe Prishtina kanë shënuar fitore të rëndësishme në kuadër të xhiros së 12-të të AlbiMall Superligës së Kosovës, duke bërë progres në renditje. Drita shënoi fitoren e saj të gjashtë në kampionat, duke e mposhtur Suharekën dhe atë si mysafire,

me përmbysje të rezultatit 2:1. Kësisoj, Drita rrëmbeu pozitën e parë, së paku për kohësisht, me 21 pikë, teksa ka dy ndeshje më pak të zhvilluara. Ndeshja nisi mirë për vendasit, të cilët shënuan të parët me anë të Mevlan Zekës në minutën e 28-të. Por Drita arriti të barazojë

shifrat në minutën e 44-t me golin e Salifu Ibrahim. Pjesa e dytë i takoi mysafirëve, me Albert Dabiqajn që realizoi golin e fitores në minutën e 67-të. Ndërkaq, Prishtina, pas dy disfatave radhazi, e gjeti fitoren në ndeshjen ndaj Ferizajt të zhvilluar, të dielën, në

stadiumin "Fadil Vokrri". Goli i vetëm i takimit u realizua nga Leotrim Kryeziu në minutën e 61-të, pas një asistimi të Albin Krasniqit. Kjo fitore bën që Prishtina të ngjitet në pozitën e tretë, me 19 pikë, aq sa ka edhe Ballkani, në pozitën e dytë dhe Malisheva, në pozitën e katërt.



Fitojnë Ylli dhe Prishtina, Trepça njofton Bashkimin me humbje

"Epoka e re"

SUHAREKË, 3 NËNTOR - Golden Eagle Ylli dhe Sigal Prishtina kanë shënuar fitore të dielën në përballje me Borën, përkatësisht Proton Cable Prizreni. Ndërsa të shtunën Peja e mposhti Vëllaznimin dhe Trepça e njoftoi Bashkimin me humbje.

Ylli e arriti fitoren e tretë radhazi, duke mundur Borën me rezultat 73:69 (18:14, 18:15, 20:20, 17:20). Sfidu u zhvillua në kuadër të javës së tetë të ProCredit Superligës. Takimi ishte interesant dhe me kthesa në rezultat, derisa vendimtar në fund ishte Arian Qallaku me 11 pikë në minutat e fundit. Therandasi e nisën ndeshjen

për mrekulli me një seri prej 12:2, por më pas u rikthyen prishtinasit, derisa çereku i parë përfundoi 18:14, derisa për një nuancë vendasit ishin më të mirë edhe në periudhën e dytë, për të shkuar në pushim me rezultat 36:29. Vendasit kishin epërsi deri në 12 pikë në periodën e tretë 52:40, derisa skuadra prishtinasit rikthehen në çerekun e fundit për të kaluar në epërsi 56:60, por vendimtar ishte Arian Qallaku me 11 pikë, nga 14 sa i shënoi në total, për fitoren 73:69. Jakorie Smith kishte 13 pikë e 11 kërcime për Yllin, ndërsa Gëzim Morina shtoi 12 pikë e 12 kërcime, ndërsa Jalen Graham kishte 25 pikë e dhjetë kërcime për Borën. Golden Eagle Ylli ka pesë fitore e tri humbje, kurse



Bora një fitore e shtatë humbje. KB Sigal Prishtina ka fituar sfidën ndaj Proton Cable Prizrenit me rezultat 100:80 (33:19, 22:23, 22:16, 23:22). Pas një fillimi të baraspeshuar 14:13, vendasit u shkëputën

deri në 14 pikë epërsi, duke e fituar çerekun e parë 33:19. Bardhekaltrit vazhduan me lojë të mirë dhe në periudhën e dytë, dyfishuan epërsinë në 46:23, por prizrenasit u rikthyen, për të afruar shifrat në

46:36, kurse pjesa e parë përfundoi 55:42. Kryeqytetasit kontrolluan lojën edhe në pjesën e dytë, për të triumfuar me 20 pikë dallim, 100:80. Damiree Burns ishte më i miri te vendasit me 23 pikë e 18 kërcime, derisa te mysafirët u dalluan John Walker me 15 pikë e shtatë kërcime dhe Lenzelle Smith me 15 pikë e shtatë asistime. Sigal Prishtina ka pesë fitore e tri humbje, derisa Proton Cable Prizreni dy fitore e gjashtë humbje. Peja ka shënuar fitore shumë të rëndësishme ndaj Vëllaznimit me shifrat 75:68 (19:13, 20:14, 20:16, 16:25). Ndërsa Trepça ka fituar në derbin e javës së tetë, duke ia shkaktuar humbjen e parë Bashkimit me rezultat 82:52 (24:7, 22:16, 19:13, 17:16).

Java e Përfaqësueses A në hendboll

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Në orët e para të së hënës, hendbollistët e Përfaqësueses së Kosovës nisen për në Torshavn të Ishujve Faroe. E gjithë java e ardhshme do të jetë në shenjë të Përfaqësueses A, që fillon fazën e dytë kualifikuese për "Euro 2026". Të mërkurën prej orës 20:00 në Torshavn është ndeshja Ishujt Faroe - Kosova. Ndeshja vlerësohet sfiduese, por djemtë tanë udhëtojnë me optimizëm për shfaqje pozitive dhe për të fituar pikë. Përfaqësuesja e Kosovës kthehet në kualifikimet e rregullta për Evropian. Në kualifikimet për Euro 2024, Kosova ishte në grup të vështirë me Slloveninë, Bosnjë-



Hercegovinën e Malin e Zi. Luajtë ndeshje të forta me gjitha këto, por pa ia dalë të kualifikohet. Kualifikimi në Evropian është synimi i madh i Kosovës. Ishujt Faroe morën pjesë në Evropianin e mbajtur në janar. Pësuan 32:29 nga Sllovenia, barazuan 26:26 me Norvegjinë dhe pësuan 32:28 nga Polonia. Nuk e kaluan

grupin e fortë. Në Torshavn, Përfaqësuesja planifikohet t'i ketë katër seanca stërvitore deri në ndeshje. Të enjten është kthimi në Kosovë dhe menjëherë nisin përgatitjet për ndeshjen me Holandën, që zhvillohet të dielën nga ora 17:15 në palestrën "1 Tetori" në Prishtinë. Holanda është favoritja e grupit. Në Evropianin e mbajtur në janar përfundoi e 12-ta. Por djemtë tanë, të përkrahur nga tifozët, synojnë suksesin edhe ndaj Holandës. Në Grupin 6 është edhe Ukraina. Ndeshjet e Kombëtares sonë me Ukrainën janë në muajin mars. Fillimisht i gjithë fokusi është te ndeshja me Ishujt Faroe.

Verstappeni triumf spektakolar në Brazil

SAO PAULO, 3 NËNTOR - Max Verstappen fitoi garën e Çmimit të Madh të Brazilit në Formula 1, duke u rikthyer te sukcesi pas gati pesë muajsh. Një triumf i jashtëzakonshëm i kampionit të botës, që pati edhe fat për shkak të shiut dhe flamurit të kuq në mesin e garës. Ai arriti të lërë shumë pas rivalin e tij për titull, Lando Norris me McLaren, që e mbylli garën në vendin e 6-të. Për pasojë, diferenca në renditje mes dy pilotëve është 62 pikë, ndërkohë që kanë mbetur edhe tri gara nga mbyllja e Botërorit. Në vendin e dytë dhe të tretë u ngjitën dy makinat Alpine, me



Alexander Albon që la pas shokun e tij të skuadrës Esteban Ocon. Ata bënë një garë të mirë në një pistë të lagur, duke përfituar nga situatat e krijuara. Në vendin e katërt u klasifikua George Russell me Mercedes e pas tij Charles Leclerc me Ferrari (i pesti).


Unitedi e Chelsea ndajnë pikët në 'Old Trafford'

MANCHESTER, 3 NËNTOR - Ishte padyshim një sfidë spektakolare, pavarësisht se përfundoi në barazim. "Djajtë e Kuq" të Manchester United ia kanë dalë të shmagjin humbjen në sfidën e javës së 10-të të Premier Ligës,

teksa në mitikun "Old Trafford" mbyllën gjithçka në barazimin 1-1, ndaj "Bluve" të Chelsea, në sfidën e parë në kampionat pa teknikun Erik ten Hag. Të parët që kaluan në avantazh ishin pikërisht "Djajtë", të cilët nisën

festën në minutën e 70'-të pas një penalltie të ekzekutuar mjeshtërisht nga Bruno Fernandes, megjithatë nuk zgjati shumë, me "shkatërruesin" ekuadorian të mesfushës Moises Caicedo, i cili barazoi shifrat vetëm

3 minuta më vonë për të mbyllur gjithçka në paqe. Falë këtij rezultati, Chelsea ngjitet në vendin e 4-të të tabelës, me 18 pikë, po aq sa Arsenal e Aston Villa, ndërsa Manchester United mbetet në vendin e 13-të me 12 pikë.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit, lidhur me nenin 15 të Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; nenin 30 të Rregullores (ZKA) nr. 02/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2024 si dhe Vendimit të Auditorit të Përgjithshëm me Nr.1785 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita:	Udhëheqës i Njësisë së Prokurimit
Numri i referencës:	UNP/ZKA/10-16/24
Grada:	ZKA-X4
Numri i pozitave:	Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgatitë, koordinon dhe zbaton Planin Vjetor të Prokurimit, në pajtim me nevojat e njëjësive kërkuese të organizatës dhe të njëjtin, përmes Drejtorit të Përgjithshëm, ia dorëzon Auditorit të Përgjithshëm për miratim, si dhe Agjencisë Qendrore të Prokurimit për informim;
- Siguron se fondet e duhura janë zotuar para nënshkrimit të kontratave;
- Siguron që të gjitha kërkesat e prokurimit janë përgatitur në përputhje me rregullat dhe procedurat e prokurimit;
- Përcakton metodologjinë e prokurimit për tenderë dhe procedurat e vlerësimit të çmimeve;
- Propozon menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrë punën e komisioneve për hapjen dhe vlerësimin e ofertave;
- Raporton në baza mujore për realizimin e projekteve dhe progresin e kontratave;
- Ofron këshilla dhe asiston menaxhmentin në marrjen e vendimeve lidhur me çështjet kontestuese që mund të dalin në rastet e ekzekutimit të kontratave dhe
- Raporton lidhur me rezultatet e punës në kuadër të Njësisë.
- Me kërkesë të Auditorit të Përgjithshëm, kryen edhe punë tjera që ndërlihen me objektivat e ZKA-së

Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

- Arsimitimi: Diplomë fakulteti në juridik, ekonomi ose administratë publike;
- Përvoja Profesionale: Pesë (5) vite përvojë pune profesionale në fushën e prokurimit publik;
- Certifikimi: Të jetë i certifikuar për prokurim publik sipas legjislacionit në fuqi.

Shkathtësitë e kërkuesit:

- Shkathtësi të avansuara në menaxhim, organizim dhe caktim të objektivave;
- Njohuri të shkëlqyeshme për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi udhëheqëse, motivuese dhe komunikuese në menaxhim të performancës;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

Informata të përgjithshme për kandidatët:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- Certifikatë sipas legjislacionit përkatës për prokurim publik;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykatat që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **19.11.2024 ora 16:00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, qdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollëshme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U prilog članu 15.2 Zakona br. 05/L-055 za Generalnog Revizora i Nacionalnu Kancelariju Revizije Republike Kosovo, kao i člana 5, 6 i 7 Uredbe (NKR) 01/2024 o Prijemu i Karijeri u Nacionalnoj Kancelariji Revizije u vezi sa članom 15 Uredbe (NKR) 03/2024 o Klasifikaciji Radnih Mesta; člana 30 Uredbe (NKR) br. 02/2024 o Unutrašnjoj Organizaciji i Sistematizaciji Radnih Mesta, Godišnjeg Plana Zapošljavanja za 2024. godinu kao i Odluku Generalne Revizorke pod br. 1785 za ispunjavanje upražnjeno radnog mesta, Nacionalna Kancelarija Revizije objavljuje:

KONKURS Za ispunjavanje slobodnog radnog mesta

1. Pozicija:	Rukovodilac Jedinice Nabavke
Referentni broj:	UNP/NKR/10-16/24
Grada:	NKR-X4
Broj pozicija:	Jedna (1)
Trajanje imenovanja:	Neograničeno

Dužnosti i odgovornosti:

- Priprema, koordiniše i sprovodi Godišnji Plan Nabavke u skladu sa zahtevima organizacije i isti, preko Generalnog Direktora, predaje Generalnom Revizoru na usvajanje, kao i Centralnoj Agenciji Nabavke radi informisanja;
- Obezbeđuje da li su određeni fondovi posvećeni pre potpisivanja ugovora.
- Obezbeđuje da li su svi zahtevi nabavke pripremljeni u skladu sa pravilima i postupcima nabavke;
- Određuje metodologiju nabavke za tendere i procese procene cena;
- Predlaže rukovodioce ugovora i nadgleda rad komisija za otvaranje i ocenjivanje ponuda;
- Izveštava na mesečnom nivou o realizaciji projekata i napretku ugovora;
- Pruža savete i pomaže menadžmentu u donošenju odluka u vezi sa spornim pitanjima koja mogu nastati u slučajevima izvršenja ugovora i
- Izveštava o rezultatima rada u okviru Jedinice.
- Na zahtev Generalnog Revizora obavlja i druge poslove u vezi sa ciljevima NKR-a;

Opšti formalni uslovi za ovo radno mesto su:

- Obrazovanje: Pravni Fakultet, ekonomski ili javne uprave;
- Profesionalno iskustvo: Pet (5) godina profesionalnog radnog iskustva u oblasti javnih nabavki;
- Sertifikacija: Da ima sertifikat za javne nabavke u skladu sa važećim zakonima.

Potrebne veštine:

- Odlične veštine u upravljanju, organizaciji i postavljanju ciljeva;
- Odlično poznavanje efektivnog nadgledanja nad stručnim radom;
- Sposobnosti zastupanja i zaštite interesa institucije i njenog integriteta;
- Liderske, motivacione i komunikacione veštine u upravljanju učinkom;
- Posedovanje dobrih međuljudskih veština.

Opšte informacije za kandidate:

Određivanje plate vrši se u skladu sa važećim zakonima.

Postupak prijave:

Postupak prijave je otvoren za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i pozdravlja kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati moraju dostaviti potrebnu dokumentaciju, i to:

- službeni obrazac NKR-a za prijavu;
- kopiju lične karte Republike Kosovo;
- dokaz o školskoj spremi (fakultetska diploma). Diplome stečene van Kosova moraju biti nostrifikovane;
- Sertifikat po važećem zakonu o javnim nabavkama.
- dokaz o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Dokaz o radnom odnosu, uz dokaz iz Trusta);
- potvrdu iz suda da nije pravosnažno osuđivan (ne stariju od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog funkcionera (ako se primenjuje);

U obzir će se uzeti samo zvanični obrazac za prijavu. Dokumenti dostavljeni nakon roka neće se razmatrati, a nepotpuni će biti odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u elektronskim medijima (online) i na internetskoj stranici Nacionalne Kancelarije Revizije. Zadnji rok za predaju dokumentacije je dana **19.11.2024 u 16.00h**.

Obrazi za prijavu mogu se dobiti na recepciji NKR-a, ili se mogu preuzeti sa web stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i predati Odeljenju za administraciju dokumenata na adresi: Naselje Arberia, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00 h, obrazac i prateća dokumentacija se mogu dostaviti i putem imejla na adresu rekrutimi@oagks.org ili putem pošte. Za detaljnije informacije možete nas kontaktirati na tel. 038/606-004, lokal 1025.

Napomena:

Prijave poslate poštom, koje nose poštanski pečat pošiljke poslate poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se važećim i biće razmatrane.

Nr: 04/24
Date: 01.11.2024

Bazuar në Programin për Zhvillim Rural 2023 të NBPZHR, Thirrjen për Aplikim nga AZHB Nr: 6820, të datës 31.10.2023, Letër informimin - Miratimin e Projektit Nr: 3703 të datës 11.06.2024, për Masën 5:Përgatitja e Zbatimi i Strategjive të Zhvillimit Lokal - qasja LEADER 2023, dhe Kontratës për financimin e Projekteve Investuese të Zhvillimit Rural Nr: 328/2024, GLV "LLAPUSHA" Malisheve shpallë:

KONKURS

Për angazhimin e një eksperti për hartimin e Strategjisë Zhvillimore Lokale të GLV "LLAPUSHA" Malisheve.

Pozita: Ekspert/e (12 ditë pune)

Fushëveprimtaria për poziten:

- Njohuri të mira për LEADER
- Zbatimi i kriterëve të LEADER
- Njohuri për programet Evropiane për zhvillimin rural (qasja LEADER)
- Identifikimin/Zhvillimin e projekteve në pajtim me Strategjinë e Zhvillimit Lokal (SZHL)

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Dëshmia për përgatitjen profesionale/Diploma Universitare
- Të dhënat personale/ CV për kandidatin
- Letra motivuese me sqarime për përvojat specifike
- Kopja e ID Republika e Kosovës
- Referencat, certifikimet dhe kualifikimet tjera

Detyrat:

- Takim konsultativ-informim për të gjithë anëtarët e GLV-së dhe palët me interes për qasjen LEADER dhe procesi i punës për përgatitjen e Strategjisë Zhvillimore Lokale
- Formimi i Grupeve punuese dhe përgatitja e formularëve për mbledhjen e të dhënave (anëtarët e GLV - Grupet Punuese
- Mbledhja e të dhënave për hartimin e Strategjisë - dokumentet në nivel Lokal dhe Qendrorë
- Organizimi i seminareve në nivel lokal
- Vizita në terren - Zonat e GLV-së
- Prezantimi i Grupeve të punës për hartimin e Strategjisë dhe informimi për qasjen LEADER si dhe faza e hartimit të dokumentit
- Hartimi i profilit të GLV-së. Analiza e gjendjes ekzistuese të zonës së GLV-së
- Hartimi i analizës SWOT sipas sektorëve
- Definimi i Analizës SWOT dhe hartimi i Vizionit, qëllimeve Strategjike, objektivat dhe aktivitetet me prioritet të GLV-së
- Analiza e Projekt Ideve si bazë për definimin e prioritetëve
- Definimi i Draftit përfundimtar të Strategjisë, vendosja në shqyrtim publik-lecturimi
- Miratimi i strategjisë në kuvendin e GLV "LLAPUSHA"

Profil:

- Diplomë universitare
- Përvojë profesionale në zhvillimin e projekteve lidhur me bujqësi dhe zhvillim rural e mirëseardhur
- Përvojë e dëshmuar e punës me programet e financuara nga BE-ja do të ishte përparësi
- Përvojë dhe aftësi në asistimin e akterëve, komuniteteve lokale dhe komunave në zhvillimin e planeve dhe strategjive zhvillimore
- Trajnim i veçantë në fushën e zhvillimit lokal apo të qëndrueshëm do të ishte përparësi
- Përvojë e dëshmuar me komunitetet lokale, komunave dhe hartimin e Strategjive Lokale do të ishte përparësi.

Aftësitë:

- Aftësi shumë të mira komunikimi
- Aftësi të punojë në ekupe, mirë i organizuar, të ketë autonomi dhe dinamikizëm
- Aftësi të mira në udhëheqjen e takimeve
- Të jetë i rrjedhshëm në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe (në shkrim dhe të folur)
- Të njeh punën me kompjuter dhe të jetë me aftësi të shkëlqyeshme shkrimi dhe diplomatike
- Njohuri për programet Evropiane për zhvillim rural (qasja LEADER) dhe procedurat do të jetë përparësi
- Njohuri themelore në Teknologjinë informative dhe komunikim (editim, video, multi-medie).

Konkursi do të jetë i hapur 10 ditë kalendare nga dita e shpalljes.
Të interesuarit mund të dergojnë Dokumentet e kërkuara deri më 11.11.2024 në zyrën e GLV, dhe në Komunën e Malisheves, ose përmes e-mailit: glvllapusha2009@gmail.com Në aplikacion duhet të ceket qasja LEADER dhe pozita 1.

LLAPUSHA - Malisheve

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Domenik Gjoka nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X të sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Burim Brovina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjinnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Jetmir Malushi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11,12 dhe diplomën e Gjinnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjinnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





TRADITË QË NGA

1992

